



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 24.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 23.06.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **RISAMONT SH.P.K.; GAFA CONSTRUCTION SH.P.K. Kroi I Bardhe Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndriqimi publik ne Medvec dhe Vrell te Magures**”, me Nr. të Prok: **613-20-1927-5-2-1**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **RISAMONT SH.P.K.; GAFA CONSTRUCTION SH.P.K. Kroi I Bardhe Prishtinë**, të dt. 23.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndriqimi publik ne Medvec dhe Vrell te Magures**”, me nr. të Prok: **613-20-1927-5-2-1**.

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë, **NSH MVR ELEKTROMONTUES, HAJVALI PRISHTINË**, i datës 19.06.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 19.06.2020;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **RISAMONT SH.P.K.; GAFA CONSTRUCTION SH.P.K. Kroi I Bardhe Prishtinë**, me datë 23.06.2020 ka parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndriqimi publik ne Medvec dhe Vrelle te Magures**”, me nr. të Prok: **613-20-1927-5-2-1**. ku ne kete aktivitet AK ka shpallur fitues **Grupit të Operatorëve Ekonomik N.SH. M.V.R.ELEKTROMONTUES ; PRISHTINE HAJVALI** për shpërblim me kontratë, të datës 22.06.2020 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik **RISAMONT SH.P.K.; GAFA CONSTRUCTION SH.P.K. Kroi I Bardhe Prishtinë** dt. 23.06.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit **Grupit të Operatorëve Ekonomik N.SH. M.V.R.ELEKTROMONTUES ; Gama Ing SH.P.K. PRISHTINE HAJVALI** Autoriteti Kontraktues, me datë 24.06.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pikat që oferta juaj eshte eliminuar jane:

Ne kerkesat e AK ne njoftim per kontrate dhe Dosje te tenderit ka qene:

1. Pretendimi juaj i Parë

Ne Njoftim per kontrate dhe dosje te tenderit tek Kërkesat e përshtatshmërisë: eshte kerkuar Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Sqarim: Ne dosjen tuaj te dorzuar ju keni marr pjese si Grup i Operatoreve Ekonomik dhe antari juaj i konzorciumit nuk ka plotesuar Deklaraten nen Betim siq edhe eshte kerkuar ne TD dhe NK. dhe oferta juaj eshte renditur si e eliminuar.

2. Pretendimi juaj i Dytë

Sqarim:Ne kete procedur tenderuese ju keni marr pjese si Grup i Operatoreve Ekonomik dhe tek marrveshjet e konzorciumit nuk keni plotesuar kushtet e arritjes se konzorciumit ju keni dorzuar vetem nje dokument te nenshkruar qe nuk i perman keto kushte shiko sqarimin te marrur nga RRUOPP

27. Grup i Operatorëve Ekonomik

27.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet te:

- Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;*
- Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar);*
- Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar; dhe*
- Secili anëtar i grupit duhet te regjistrohet ne platformën elektronike. Sidoqoftë kjo kërkesë duhet te përcaktohet ne Dosjen e Tenderit.
(Nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri ne njoftim zyrtar nga KRPP);*

3. *Pretendimi juaj i Tretë*

Kerkesa 3: (Kapaciteti teknik dhe profesional)

Lista e pajisjeve teknike a. Eskavator - min 2 copë b. Kamion - min 1 copë e. Cilinder per ngjeshjen (min 1 cope), d. Makine per shpim horizontal nen rruge per vendosjen e kabllave min 1 cope, e. Kompresor per thyrje te pjeseve te forta (beton, asfalt) min 1 copë, e) Auto korpe (shporte) min 2 cope, f) Kamion Auto Kran min 1 cope g) Burgi Hidraulike per shpim verikal per vendosje te shtyllave min 1 cope.

Deshmia 3: Lista e paisjeve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen. Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim me deshmit tjera percjellese.

Sqarim: Kerkese e OE ka qene - Kompresor per thyrje te pjeseve te forta (beton, asfalt) min 1 copë, kurse si deshmi eshte kerkuar Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen

Ju keni dorzuar nje marrveshje per shfrytzim me Tali SHPK te mjeteve dhe deshmite e dorzuara nga ana juaj nuk jane baze kerkeses se AK, edhe marrveshja tjeter me NSH Raketa keni dorzuar nje DUD Doganor qe nuk eshte prone e NSH Raketa kurse marrveshja eshte me kete kompani (vrejtje: dudi doganor shumicen e fjaleve kryesore i ka te fshira)

4. *Pretendimi juaj i Katër*

Sqarim: Kerkese e OE ka qene - Burgi Hidraulike per shpim verikal per vendosje te shtyllave min 1 cope. *Deshmi Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes*

Ju keni dorzuar disa fotografi dhe nje fatur me marrveshje te nje motori shpues me dore qe perdoret per oborre dhe nevoja personale, dhe keto deshmia tuajat nuk kane te beje asgje me kerkesen e AK.

5. *Pretendimi juaj i Pestë*

Sqarim: Kerkese e OE ka qene - Cilinder per ngjeshjen (min 1 cope), kurse si deshmi eshte kerkuar Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen.

Per cilinder nuk keni dorzuar asnje deshmi te vetme siq eshte kerkuar ne Njoftim per Kontrate dhe TD

6. *Pretendimi juaj i Gjashtë*

Ne dosjen tuaj qe keni bashkangjitur ne kete procedur ju si GOE qdo dokument qe dorzoni eshte i rendesishem gjithashtu po ju sqarojme qe shumica e dokumenteve jane te paqarta apo te fshira me qellim siq jane: Kontratat e ndryshme, marrveshjet e ndryshme Dudat Doganor, Librezat etj

Sqarimet shtese me pretendimet per OE te propozuar per kontrate

1. **Pretendimi juaj i parë** për mjetin e punës *Burçi Hidraulike për shpim verikal për vendosje të shtyllave min 1 cope*, që ky mjet pune nuk është në baze të kërkesës së AK

Ky pretendim nga ana juaj eshte i pabazuar sepse eshte deshmia qe oe perket kete burgji qe ceket qarte ne dud(*Veger per birime ne shkemb apo toke, burgi shpuese per shtylla elektrike*) qe eshte ne baze te kerkeses se AK te bashkangjitur gjeni dudin doganor ne pronesi te vet OE

[illegible]

2. **Pretendimi juaj i Dytë:** OE i propozuar per Kontrate ka nje marrveshje per Mjetin Cilinder te nenshkruar dhe vulosur gjithashtu ka te bashkangjitur edhe faturen per kete mjet pune qe eshte ne baze te kerkesave te AK dhe ky **pretendim i juaji eshte i pabazuar**
3. **Pretendimi i juaj i trete:** OE i propozuar per kontrate ka te bashkangjitur marrveshjen per Kompresor me OE NTSH XHEMA COM qe ka te paisur edhe dudin doganor ne pronesi te oe qe ka marrveshjen dhe eshte ne baze te kerkesave te AK, ky **pretenim i juaji eshte i pabazuar**
4. **Pretendimi i juaj i kater:** OE i propozuar per kontrate ka nje kamion me marrveshje me OE NTSH XHEMA COM ku ka te bashkngjitur edhe Dudin doganor ne pronesi te kesaj kompanie dhe kjo deshmi eshte ne baze te kerkesave te AK, **pretenimi i juaj eshte i pabazuar**

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Adem Duriqi
Drejtor i Prokurimit

